


Nr. regj. 30764/12



GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Ejup Hasani nga Obiliqi, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Larte Publike te Larte Publik nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73.73.195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 24.09.2012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Ejup Mahmut Hashani, i lindur më 31.03.2012 në Obiliq, ku edhe tani jeton në Rr. Daut Hashani pn. Në Obiliq, i martuar baba i pesë fëmijëve, Kryesues i bordit të Drejtoreve në Kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina, fakultetin e kryer, i gjendjes së mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Ë shtë pë r g j e g j e s

Sepse me si Zyrtar i larte Publik, në Pozite Kryesues i bordit të Drejtoreve në Kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 paragraf. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Larte Publike**, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

DENIMI

Me gjobë në shumë prej **1000 (njëmijë)** Euro. Gjjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të marrë formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po që se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjjobën e njejtë do të zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njejtë sikurse gjjobën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr. 01 2494/12 të dt. 13.07.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të shënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit, me, i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se si Kryesues i bordit të Drejtoreve në Kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë, pasi që me dt. 23 mars 2012 i ka vdekur nena dhe për shkak të ceremonisë mortore nuk ka mundur të bëjë deklarin e pasurisë brenda afatit ligjor.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin i deklaratës së të pandehurit, ushtruesit të Kërkesës Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe baze të dhënave të parashtruara në kërkesë, shqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është dënuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kurse mbrojtjen e të pandehurit e hudhi si të pa bazë.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK morri si rrethanë lehtësuese rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, por nuk e arsyetoi kohen kohen para dt. 23 mars 2012 andaj të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit të i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksa.